



## NJOFTIM I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE MBI PAGESËN E DETYRIMEVE TATIMORE NË MËNYRË ELEKTRONIKE

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), nëpërmjet njoftimit të publikuar sot, në faqen zyrtare **[www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)**, këshillon tatimpaguesit se mund të kryejnë pagesat e detyrimeve tatimore elektronikisht nëpërmjet dy formave të mëposhtme:

- **Nëpërmjet shërbimit online banking, që ofrohet nga bankat e nivelit të dytë.**  
Në njoftimin e DPT-së është publikuar edhe lista e bankave që e ofrojnë këtë shërbim, së bashku me link-et përkatëse, ku mund të merret informacion mbi oraret e funksionimit dhe vendndodhjes së sporteleve të bankave të nivelit të dytë; si dhe
- **Nëpërmjet Platformës Qeveritare të Pagesave në portalin e-albania.**  
Informacion me të detajuar mbi kushtet dhe mënyrën e kryerjes së pagesave nëpërmjet e-albania gjeni duke klikuar në linkun:  
<https://e-albania.al/Pages/HelpPayments.aspx>

Për më tepër informacion në lidhje me kryerjen e pagesave të detyrimeve tatimore në mënyrë elektronike, mund të drejtoheni në linkun më poshtë:

<https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1280/informacion-mbi-mundesine-e-pageses-se-detyrimeve-tatimore-nepermjet-portalit-e-albania-si-dhe-online-banking-ne-bankat-e-nivelit-te-dyte>



## NOTIFICATION OF THE GENERAL TAX DIRECTORATE ON THE ELECTRONIC PAYMENT OF TAX LIABILITIES

The General Directorate of Taxes (GDT), through a notice published today on the official website [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al), advises taxpayers that they can pay their tax liabilities electronically through the following two forms:

- **Through online banking service offered by commercial banks.**  
The list of banks offering this service is published in the GTD notice, together with the relevant links, where you can find information on the opening hours and location of commercial banks; and
- **Through the Government Payment Platform on the e-albania portal.** You can find more detailed information on how to make payments via e-albania, by clicking on the link: <https://e-albania.al/Pages/HelpPayments.aspx>

For more information about electronic tax payments, please refer to the link below:  
<https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1280/informacion-mbi-mundesine-e-pageses-se-detyrimeve-tatimore-nepermjet-portalit-e-albania-si-dhe-online-banking-ne-bankat-e-nivelit-te-dyte>